



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:143221
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05472290

Cnr.855/22

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.S., nga fshati ... komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Kompania Regjionale e Ujitjes “R.-D.”, Sh.A., me seli në Gjakovë, me objekt kontesti anulim i vendimit, jashtë shqyrtimit, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e palejueshme padia e evidentuar me numrin C.nr.855/22, e parashtruar me datë 13.07.2022 nga paditësi N.S., nga fshati ..., komuna e Gjakovës, me objekt kontesti anulim i vendimit, për shkak se padia është paraqitur pas skadimit të afatit për paraqitjen e saj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të të autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datë 13.07.2022, ka paraqitur padi për anulim të vendimit kundër të paditurës Kompania Regjionale e Ujitjes “R.-D.”, ShA., me seli në Gjakovë, duke kërkuar nga gjykata që të anulojë vendimin e të paditurës me numër protokolli 331, të datës 24.05.2022, dhe të obligoi të paditurën që paditësit t’i paguaj 50 % të pagës që i është ndalur nga data 01.06.2022 e deri me datë 31.07.2022, shumë neto (sipas ekspertizës), në emër të kontributit pensional shumë (sipas ekspertizës) si dhe në emër të tatimit në pagë shumë (sipas ekspertizës), me kamatë ligjore prej 8 %, e cila llogaritet nga arritja e secilës kërkesë veç e veç, nga data 01.06.2022 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar duke kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta hudhë poshtë apo ta refuzoi

si të pa themeltë dhe ta detyrojë paditësin në kompensim të shpenzimeve procedurale në emër të përpilimit të përgjigjes në padi, përfaqësim sipas TA duke llogaritur edhe taksën gjyqësore.

Duke qenë se gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare rreth afatshmërisë së padisë në kontestet nga marrëdhënia e punës lidhur me të drejtat nga marrëdhënia e punës, përfshirë çfarëdo të drejte lidhur me statusin e punëtorit nga marrëdhënia e punës si dhe marrë parasysh faktin se nga përshkrimi në padi gjykata nuk ka mundur të konstatoi kohën e saktë se kur paditësi e ka pranuar nga e paditura vendimit nr.331, të datës 24.05.2022-objekt i këtij kontesti, atëherë për të vërtetuar këtë fakt gjykata me datë 05.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në prani të paditësit dhe të të autorizuarit të tij si dhe në prani të përfaqësuesit të të paditurës. Në seancën përgatitore në pyetjen e gjykatës e drejtuar të të autorizuarit të paditësit rreth kohës së pranimit të vendimit-objekt i këtij kontesti nga paditësi, i njëjti ka deklaruar se paditësi vendimin e ka pranuar me datë të protokollimit të të njëjtit, pra me datë 24.05.2022, por megjithatë bordi i të paditurës me atë 17.06.2022 ka marrë vendim për ankesën e paditësit, ankesë e ushtruar brenda afatit ligjor. Pas një deklarimi të tillë, gjykata ka vendosur që lidhur me afatshmërinë e paraqitjes së padisë të marrë vendim të veçantë jashtë seance.

Gjykata vë në pah faktin se afati për paraqitjen e padisë në kontestet nga marrëdhënia e punës kur cenohen të drejtat e punëtorit nga punëdhënësi, është afat prekluziv. Në rast të tejkalimit të afatit prekluziv, padia është gjithmonë e pas afatshme, pa marrë parasysh arsyet e lëshimit të afatit, e për të cilat afate gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga shkresat e lëndës dhe nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse në seancën përgatitore, gjykata ka vërtetuar faktin se vendimi, anulimi i të cilit kërkohet, përkatësisht Vendimi i nxjerrë nga e paditura me numër të protokollit 331, sipas të cilit *“I punësuar N.S., në vendin e punës si rojtar është përgjegjës për shkelje të përsëritura të detyrave të punës....i shqiptohet masa ndëshkuese suspendim i përkohshëm duke filluar nga data 01.06.2022 e deri me datë 31.07.2022 dhe gjatë kohës së largimit të përkohshëm të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50 % të mesatares së të ardhurave të realizuara në tre muajt e fundit”* është marrë nga e paditura me datë 24.05.2022 dhe po në të njëjtën datë i është dërguar edhe paditësit. Ndaj këtij vendimi paditësi me datë 30.05.2022 ka parashtruar ankesë pranë të paditurës, ndërsa e paditura në mbledhjen e bordit të drejtorëve të datës 17.06.2022 kishte refuzuar ankesën vetëm për periudhën e suspendimit për 2 muaj, ndërsa nuk ka vendosur për uljen në pagë, vendim ky i cili i është kumtuar gojarisht paditësit. Ndërsa padia në këtë gjykatë është paraqitur me datë 13.07.2022.

Duke qenë se me dispozitën e nenit 391 pika (f) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) parashihet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme, po që se konstaton se: pika f), padia është paraqitur pas skadimit të afatit po që se me dispozitat e posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*, dhe në dispozitën e nenit 79 të Ligjit të Punës përcaktohet se: *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2, të këtij ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”*, gjykata, pasi që nga shkresat e lëndës dhe

deklarimi i ndërgjyqësve konstatoi faktin se vendimi, anulimi i të cilit kërkohet, përkatësisht Vendimi i nxjerrë nga e paditura me numër të protokollit 331, është marrë me datë 24.05.2022, ndërsa padia në këtë gjykatë është parashtruar me datë 13.07.2022, gjeti se padia e paditësit është e pas afatshme. Deri te një konstatim i tillë gjykata erdhi bazuar në faktin se paditësi ndaj vendimit nr. 331 të datës 24.05.2022 ka parashtruar ankesë pranë të paditurës me datë 30.05.2022, ndërsa lidhur me ankesën e paditëses Bordi i Drejtorëve të të paditurës pjesërisht kishte vendosur në mbledhjen e datës 17.06.2022. Pra vendimi i të paditurës lidhur me ankesën e paditësit nuk është marrë brenda afatit prej 15 ditëve të përcaktuara në nenin 78 par.2 të Ligjit të Punës. Për këtë arsye paditësi ka qenë dashur që në afatin vijues prej 30 ditësh të paraqesë padi në gjykatë, duke mos e pritur vendimin e të paditurës. Mirëpo, padia në këtë gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore është parashtruar pas një muaji e njëzet dite që nga marrja e vendimit-objekt i këtij kontesti (24.05.2022- data e marrjes së vendimit dhe 13.07.2022- data e parashtrimit të padisë). Andaj gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk mund të ushtrojë padi në gjykatë për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënies e punës sepse e njëjta ka tejkalar afatin ligjor për paraqitjen e saj, për çka gjykata padinë e paditësit e hudhi poshtë si të pa lejuar në këtë çështje konstetimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës bazohet në nenin 452 par.1 lidhur me neni 463 të LPK-së, për faktin se e paditura nuk ka specifikuar shpenzimet e kërkuara procedurale.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore nga neni 391 pika f) të LPK-së, neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.855/22, datë 19.03.2024

Gjyqtarja,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.